

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë është karakterizuar me dinamikë të përshpejtuar përgjatë TM1 2017. Po ashtu, shkalla e inflacionit në eurozonë shënoi rritje në 1.8 përqind, ndikuar kryesisht nga politika e lehtësuar monetare në eurozonë dhe rritja e çmimeve të energjisë.

Lehtësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimi i kërkesës së brendshme kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në eurozonë. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor, të cilat u karakterizuan me rritje të eksporteve, investimeve si dhe konsumit të brendshëm.

Rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë TM1 2017 është mbështetur kryesisht nga përforsimi i kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve. Sipas vlerësimeve të ASK-së, përgjatë vitit 2016 ekonomia e Kosovës është karakterizuar me një rritje mesatare të BPV-së prej 3.4 përqind, ndërsa për TM1 2017, ASK ka vlerësuar rritje reale prej 3.9 përqind. Gjatë TM1 2017, niveli i çmimeve të konsumit në Kosovë është karakterizuar me rritje mesatare të shkallës së inflacionit prej 1.5 përqind. Gjithashtu, në këtë periudhë, indeksi i çmimeve të importit dhe prodhimit u karakterizuan me rritje.

Sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Në TM1 2017, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 5.9 milionë euro, krahasuar me bilancin prej 2.8 milionë euro në TM1 2016.

Në TM1 2017, bilanci i pagesave në Kosovë shënoi rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, kryesisht si pasojë e rritjes më të theksuar të importit të mallrave (8.3 përqind) krahasuar me rritjen e eksportit të mallrave (6.2 përqind). Rritja e eksportit dhe rënia e importit të shërbimeve ndikoi në rritjen e bilancit pozitiv të llogarisë së

shërbimeve. Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 kanë shënuar rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Gjatë TM1 2017, sektori bankar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues (10.9 përqind), kryesisht si rezultat i lehtësimit të kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në këtë periudhë shënuan një rritje vjetore prej 9.3 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi në mars 2017 u zvogëlua në 7.0 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje në 1.0 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të përcjellë trend rënës, duke zbritur në 4.5 përqind në deri në mars 2017, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të qëndrojnë në nivele të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, sektori pensional realizoi kthim nga investimet dukshëm më të lartë se periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu edhe sektori mikrofinanciar dhe sektori i sigurimeve u karakterizuan me rritje të profitit në mars 2017 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	04
Ekonomia e Kosovës -----	06
Sektori Real-----	06
Regjistri i bizneseve -----	07
Sektori Fiskal-----	08
Sektori i Jashtëm-----	09
Sistemi Financiar-----	11
Sektori Bankar-----	11
Sektori Pensional-----	19
Sektori i Sigurimeve-----	20
Sektori Mikrofinanciar-----	21
Tregu i Letrave me Vlerë-----	24

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë-----	04
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së-----	05
Figura 3. Norma e inflacionit-----	06
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	07
Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit-----	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	07
Figura 8. Regjistri i bizneseve-----	08
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	09
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	09
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 13. Remitencat-----	10
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	11
Figura 15. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës-----	11
Figura 16. Asetet e bankave komerciale-----	11
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave-----	12

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	13
Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik -----	13
Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	13
Figura 21. Depozitat -----	14
Figura 22. Struktura e depozitave -----	14
Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	15
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	15
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	15
Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita -----	16
Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje -----	16
Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	16
Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar-----	17
Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	17
Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	18
Figura 32. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	18
Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	18
Figura 34. Asetet e sektorit pensional -----	19
Figura 35. Investimet e FKPK-së -----	19
Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	20
Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	20
Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive-----	22
Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	22
Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	22
Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	23
Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	23
Figura 46. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	24
Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	24
Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit-----	25
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	05
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës -----	24
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	27

SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Gjatë TM1 2017, eurozona u karakterizua me një dinamikë të përshpejtuar të aktivitetit ekonomik. Përforcimi i mëtejshëm i kërkesës së brendshme në eurozonë, veçanërisht përforcimi i pozicionit të investimeve, është reflektuar pozitivisht në rritjen reale të ekonomisë. Gjithashtu, kushtet e financimit në eurozonë vazhduan të mbesin të lehtësuara, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior, duke mbështetur më tej rikuperimin e aktivitetit ekonomik. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në TM1 2017, ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 1.9 përqind. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, eurozona u karakterizua me rritje të BPV-së prej 0.6 përqind (figura 1). Rritja e vlerës së shtuar në BPV nga sektorët e ndërtimit, prodhimit dhe bujqësisë u përkthye në rritje të aktivitetit ekonomik në eurozonë gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2017, BQE ka parashikuar një rritje reale të BPV-së prej 1.9 përqind, mbështetur kryesisht në përforcimin e eksporteve të eurozonës dhe politikën e lehtësuar monetare.

Rritja ekonomike në eurozonë në TM1 2017 mbeti e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermani (1.7 përqind), Francë (1.0 përqind), Holandë (2.8 përqind), Itali (1.2 përqind) dhe Spanjë (3.0 përqind).

Në mars 2017, norma e inflacionit arriti në 1.8 përqind, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak kur ishte 0.0 përqind. Politika e lehtësuar monetare dhe rritja e çmimit të energjisë janë

reflektuar në rritje të shkallës së inflacionit në periudhën raportuese.

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2017)


Për vitin 2017, sipas parashikimeve të BQE-së, shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 1.5 përqind.

Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 është reflektuar në rënien e normës 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Megjithatë, në TM1 2017, norma 12 mujore e interesit të kreditimit ndërbankar në eurozonë u karakterizua me rritje. BQE-ja vazhdoi të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind (figura 2).

Në tremujorin e parë të vitit 2017, aktiviteti kreditues në eurozonë ka vazhduar rikuperimin, duke u karakterizuar me një rritje vjetore prej 2.4 përqind. Zgjerimi i aktivitetit kreditues është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës, që ka rezultuar nga përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe përshpejtimi i aktivitetit ekonomik. Gjatë TM1 2017, ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje më të shpejtë prej 2.5 përqind, përderisa kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje vjetore prej 1.7 përqind.

Gjatë kësaj periudhe, rritja e të ardhurave në dispozicion në eurozonë mund të ketë ndikuar në rritjen e depozitave të rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (8.2 përqind), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (5.3 përqind).

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2017) dhe BQE (2017)

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë TM1 2017 vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në disa vende të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve të huaja dhe konsumit të brendshëm, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej 3.5 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në TM1 2017 (tabela 1).

Sikurse edhe në eurozonë, rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare është reflektu në rritje të shkallës së inflacionit në Ballkanin Perëndimor. Në TM1 2017, Mali i Zi u karakterizua me shkallë inflacioni prej 2.8 përqind, pasuar nga Maqedonia (0.6 përqind), Serbia (3.6 përqind) dhe Shqipëria (2.1 përqind).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.2	3.0	3.2
Kosova	3.4	1.2	4.1	3.4	3.7*
Mali i Zi	3.5	1.8	3.2	5.1	3.6
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	2.2	3.5
Serbia	2.6	-1.8	0.7	2.5	2.8
Shqipëria	1.0	1.8	2.8	3.4	3.7

*Parashikim preliminar i BQK-së

Burimi: WEO (2017) dhe vlerësimi i BQK-së

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e rajonit u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues në këtë periudhë, ku rritjen më të lartë e kishte Kosova me 10.9 përqind, Serbia (4.6 përqind) dhe Mali i Zi (5.5 përqind), përderisa rënie raportoi Maqedonia (0.2 përqind). Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, ku Serbia shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në mars 2017 (12.1 përqind), pasuar nga Mali i Zi (9.5 përqind), përderisa rritjen më të ulët shënoi Shqipëria (3.7 përqind).

Deri në mars të vitit 2017, euro është zhvlerësuar lehtësisht kundrejt valutave të mëdha si dollarit amerikan dhe frankës zvicerane ndërsa është vlerësuar kundrejt sterlinës britanike. Gjatë TM1 2017, norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan dhe frankës zvicerane është zhvlerësuar për 3.4 përqind përkatësisht 2.4 përqind, ndërsa kundrejt sterlinës britanike është vlerësuar për 11.6 përqind. Në kuadër të monedhave të rajonit, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb për 0.8 përqind përderisa është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar dhe denarit maqedon për 1.8 përqind përkatësisht 0.2 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori real

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ka shënuar rritje mesatare të BPV-së përgjatë katër tremujorëve të vitit 2016 prej 3.4 përqind.

Në tremujorin e parë të vitit 2017, vlerësimet e ASK-së sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 3.9 përqind, rritje kjo e gjeneruar nga rritja e investimeve prej 13.7 përqind si dhe rritja e konsumit prej 1.6 përqind. Në këtë periudhë, neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me rritje të deficitit prej 3.3 përqind në terma real. Sa i përket qasjes së prodhimit, rritja vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga ndërtimtaria (rritje prej 16.4 përqind), tregtia (7.1 përqind), aktivitetet financiare (12.1 përqind), afarizmi me pasuri të patundshme (5.9 përqind), si dhe industria nxjerrëse dhe përpunuese (21.9 përkatësisht 5.3 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek bujqësia (4.0 përqind) dhe administrimi publik (3.9 përqind rënie).

Parashikimet e BQK-së për vitin 2017 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale prej 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të kenë ndikim më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar. Konsumi si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.1 përqind, ndërsa investimet parashihet të shënojnë rritje reale prej 6.8 përqind. Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2017 pritet të kenë një kontribut më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar, supozim


i mbështetur kryesisht në parashikimet për rritje të çmimeve të metaleve që priten të ndikojnë në rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve.

Çmimet

Gjatë TM1 2017, niveli i çmimeve në Kosovë është karakterizuar me rritje. IÇK shënoi rritje mesatare prej 1.5 përqind në këtë periudhë (figura 3).

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet e transportit (6.0 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.1 përqind), veshmbathjes (2.2 përqind), rrymës dhe lëndëve tjera djegëse (2.1 përqind). Me rritje prej 1.0 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.


Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek rekreacioni dhe kultura (1.3 përqind) si dhe mjetet e komunikimit (0.7 përqind) (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Indeksi i çmimeve të importit, në TM1 2017, shënoi rritje prej 5.1 përqind (figura 5).

Figura 5. Indeksat e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2017)

Çmimet e produkteve minerale, të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (24.9 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujt e saj shënuan rënien më të lartë të çmimeve (4.6 përqind) (figura 6).

Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rritje prej 0.9 përqind. Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit dhe prodhimi i tyre, prodhimi i pajisjeve elektrike, energjia elektrike, etj.


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Ndërsa, me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht prodhimi i lëkurës dhe produkteve të saj, prodhimi i pijeve, etj. (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, në TM1 2017 është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara dhe numër dukshëm më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 2,850 apo 46 ndërmarrje më pak se sa në TM1 2016, ndërsa u mbyllën 445 ndërmarrje apo 282 ndërmarrje më pak se sa në TM1 2016 (figura 8).


Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2017)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 799 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i bujqësisë me 350 ndërmarrje dhe ndërtimtarisë me 269 ndërmarrje (figura 9).

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2017)

Krahasuar me TM1 2016, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit është shënuar rënia më e madhe e ndërmarrjeve të regjistruara prej 78 ndërmarrje më pak, pasuar nga sektori i aktiviteteve financiare që u karakterizua me 45 ndërmarrje më pak të regjistruara. Sektorët që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të

regjistruara ishin sektori i bujqësisë dhe ndërtimtarisë (89 përkatësisht 15 ndërmarrje më shumë).

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në TM1 2017 arritën vlerën neto prej 339.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore rreth 3.1 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet buxhetore² arritën vlerën prej 333.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore rreth 2.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 5.9 milionë euro krahasuar me bilancin prej 2.8 milionë euro në TM1 2016.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 57.3 milionë euro (7.8 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 252.6 milionë euro (2.1 përqind rritje). Rritje edhe më e lartë e të hyrave buxhetore prej 14.9 përqind është shënuar tek të hyrat jo-tatimore, që në TM1 2017 arritën vlerën prej 44.9 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje përveç mallrave dhe shërbimeve të cilat shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 0.6 përqind dhe arritën vlerën prej 136.6 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu shënuan rritje për 9.2 përqind dhe arritën vlerën prej 108.2 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 16.8 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore,

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

shënuan rritje prej 9.9 përqind dhe arritën vlerën 56.2 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime shënuan rënie për 0.8 përqind dhe arritën vlerën prej 33.9 milionë euro.


Borxhi publik arriti në 942.7 milionë euro në TM1 2017, që tregon për një rritje prej 18.0 përqind krahasuar me TM1 2016. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 15.0 përqind, nga 13.6 përqind sa ishte në TM1 2016. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm prej 19.0 përqind (vlera e të cilit ka arritur në 463.4 milionë euro) dhe borxhit të brendshëm prej 17.0 përqind (479.3 milionë euro). Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin e brendshëm është rritur në 49.2 përqind, nga 48.7 përqind sa ishte në TM1 2016.

Sektori i Jashtëm

Gjatë TM1 2017, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 166.7 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 138.7 milionë euro sa ishte në TM1 2016. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet kryesisht rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan rritje.

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 8.3 përqind në TM1 2017. Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 76.4 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.2 përqind (figura 10).³


Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2017)

Rritja e vlerës së eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të ushqimeve të përgatitura, pijeve, produkteve të plastikës, gomës, lëkurës, etj. Në anën tjetër, me rënie u karakterizua eksporti i metaleve bazë, i cili përbën rreth 42 përqind të gjithsej eksportit, pastaj tekstili dhe artikujt e tekstilit, si dhe eksporti i këpucëve (figura 11).

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 609.4 milionë euro deri në mars 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 8.3 përqind. Rritja e importit ishte kryesisht rezultat i rritjes së produkteve minerale, ku përfshihet importi i naftës dhe derivateve të saj,

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

çmimet e të cilave janë rritur në tregjet ndërkombëtare. Me rritje është karakterizuar edhe importi i mjeteve transportuese, makinerive, ushqimeve të përgatitura, pijeve, etj. Në anën tjetër, importi plastikës, artikujve të gurit, qeramikës, qelqit, etj. shënuan rënie (figura 12). Në mars 2017, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte qëndroi në 12.5 përqind (12.8 përqind në mars të vitit 2015).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 68.4 milionë euro, një rritje kundrejt TM1 2016 prej 3.8 përqind. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 1.5 përqind, duke arritur në 155.7 milionë euro, përderisa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rënie prej 0.3 përqind dhe arriti në 87.3 milionë euro.

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet pensionale dhe të sigurimit u karakterizuan me rritje, ndërsa shërbimet e ndërtimit shënuan rënie. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit shënuan rënie ndërsa shërbimet e kompjuterike shënuan rritje.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje prej 5.3 përqind. Bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punonjësve⁴ shënoi rritje për 1.2 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave të realizuara nga investimet u zvogëlua për 1.5 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 3.0 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 163.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.3 përqind (figura 13).

Figura 13. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 38.5 përqind përkatësisht 22.8 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.7 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

⁴ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qëndrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 68.4 milionë euro, që paraqet një rritje prej 22.9 përqind krahasuar me TM1 2016. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 14).


Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 81.0 përqind të gjithsej IHD-ve, arriti vlerën prej 55.4 milionë euro dhe shënoi rritje prej 17.4 përqind kundrejt TM1 2016. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit arritën vlerën prej 13.0 milionë euro, një rritje prej 54.0 përqind. Rritje më të lartë të IHD-ve shënuan sektori i shërbimeve financiare (46.2 përqind rritje vjetore), përderisa sektori i patundshmërive u karakterizuan me rënie vjetore prej 28.7 përqind.

Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.51 miliardë euro në mars

2017, që paraqet një rritje vjetore prej 11.0 përqind (figura 15).

Figura 15. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2017)


Rritja e asetëve të sektorit bankar dhe veçanërisht atij pensional mbetën kontribuuesit kryesor në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar në vend.

Sektori Bankar

Asetet

Në mars 2017, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 8.0 përqind, duke arritur në 3.67 miliardë euro (figura 16).

Figura 16. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet



Burimi: BQK (2017)


Zgjerimi i portfolios së kredive ishte kontribuuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar. Kjo rritje e portfolios mbështet kryesisht në rritjen e vazhdueshme të depozitave të sektorit bankar, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues në vend.

Në mars 2017, stoku i letrave me vlerë i sektorit bankar shënoi ngadalësim të rritjes në 5.0 përqind, nga rritja e shënuar në vitin paraprak prej 16.8 përqind. Ky ndryshim vjen si pasojë e ngadalësimit të rritjes së investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në 3.0 përqind (11.3 përqind në mars 2016), dhe rënies së investimeve në letrat me vlerë të qeverive të huaja prej 3.4 përqind (22.1 përqind në mars 2016). Ngadalësimi i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës mund t'i atribuohet deri në një masë ndryshimit të strategjisë investuese të bankave, duke pas parasysh rënien e normës mesatare të interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe për pasojë, fitimit më të ulët të realizuar nga këto investime. Në anën tjetër, përmirësimi i vazhdueshëm i portfolios kreditore dhe kthimi më i lartë nga investimet në kredi, ka ndikuar që bankat të zhvendosin investimet e tyre drejtë kreditimit, që në këtë periudhë është karakterizuar me rritje të përshpejtuar. **Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rënie vjetore prej 1.5 përqind krahasuar me rritjen në vitin paraprak prej 5.9 përqind.** Rënia e kësaj kategorie pjesërisht mund të jetë ndikuar nga zhvendosja e mjeteve drejt rritjes së kreditimit, si dhe nga norma negative e interesit e aplikuar nga BQK për rezervat e bankave mbi nivelin e rezervës së detyrueshme.

Kreditë

Kreditë e sektorit bankar përshpejtuan rritjen vjetore në 10.9 përqind (figura 17). Në mars 2017, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.29 miliardë euro. Rritja e kreditimit i atribuohet kryesisht lehtësimit të ofertës kreditore nga sektori bankar përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit, gjegjësisht përmes uljes së normës së interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuar, zgjatjes së maturitetit dhe zvogëlimit të kërkesave për kolateral.


Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Stoku i kredive ndaj ekonomive familjare ishte kategoria që shënoi normën më të lartë të rritjes vjetore prej 14.0 përqind deri në mars 2017 (figura 18). Ndërsa, kreditë e reja të lëshuara për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie të lehtë vjetore prej 1.8 përqind në TM1 2017.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje të përshpejtuar vjetore në periudhën raportuese (figura 18).


Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2017)

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga 'kreditë tjera' dhe ato për prodhimtari (figura 19).


Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (mars 2017)



Burimi: BQK (2017)

Në mars 2017, kreditimi i të gjithë sektorëve ekonomik shënoi rritje (figura 20). Rritje vjetore të kreditimit shënuan veçanërisht sektori i ndërtimtarisë dhe i tregtisë prej 11.4 përkatësisht 8.3 përqind.

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje të theksuar vjetore prej 25.8 përqind, ku kategoria e kredive investuese shënoi rritje vjetore prej 9.2 përqind përderisa ajo e kredive jo-investuese shënoi rritje vjetore prej 53.4 përqind. Rritja e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve e reflekton kryesisht rritjen vjetore të kredive të reja ndaj sektorit të industrisë dhe të shërbimeve, prej 20.2 përkatësisht 20.1 përqind.

Deri në mars 2017, përshpejtimi i aktivitetit kreditues iu atribuua rritjes së shpejtë të kredive familjare si dhe kredive ndaj ndërmarrjeve, të mbështetura kryesisht nga përmirësimi i ofertës kreditore. Sa i përket strukturës së sektorëve ekonomik, ajo vazhdoi të mbetet e ngjashme me tremujorët paraprak. Rritje vjetore të theksuar të kreditimit kishte sektori i ndërtimtarisë dhe sektori i tregtisë.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 79.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor


të financimit të aktivitetit të sektori bankar. Pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të kategorisë së detyrimeve vazhdojnë të mbesin edhe kategoria e ‘obligimeve tjera’ dhe ‘bilanci me bankat komerciale’.

Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 7.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar të vlerës së fitimit aktual dhe fitimit të mbajtur në 21.6 milionë euro (16.9 milionë në mars 2016), përkatësisht 142.6 milionë euro (118.7 milionë euro në mars 2016).

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 9.3 përqind, ritëm ky i përsheptuar krahasuar me periudhat paraprake (3.5 përqind në mars 2016). Deri në mars 2017, depozitat arritën në 2.91 miliardë euro (figura 21).

Figura 21. Depozitat, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, që dominojnë strukturën e gjithsej depozitave,

të cilat shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind (figura 22).

Figura 22. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


Në periudhën e njëjtë, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore të përsheptuar prej 22.0 përqind, që mund të jetë ndikuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet. Vlen të theksohet se kategoria e depozitave të transferueshme vazhdoi të rrisë pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave përderisa depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat, që mund t'i atribuohet deri në një masë normës së ulët mesatare të interesit në depozita.

Depozitat vazhduan të rriten me ritëm të përsheptuar. Struktura e depozitave vazhdon të ndryshojë në favor të depozitave të transferueshme, përderisa kategoritë e depozitave të afatizuara dhe atyre të kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.

Normat e Interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 6.1 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (6.5 përqind në mars 2016).

Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2017)

Norma mesatare e interesit në kredi në mars 2017 u zvogëlua në 7.0 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje në 1.0 përqind (figura 23).


Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 6.8 përqind nga 7.0 përqind sa ishte në mars 2016 (figura 24).

Në kuadër të kësaj kategorie, normat e interesit në kreditë investuese dhe jo-investuese vazhdojnë të përcjellin trend rënës.

Në mars 2017, vërehet rënie më e lehtë e normave të interesit në kreditë për ndërmarrjet në krahasim me periudhat paraprake.


Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në të gjithë sektorët ekonomik, përveç 'sektorëve tjerë', shënuan rënie. Norma e interesit në sektorin e bujqësisë shënoi rënie me ritëm më të përshpejtuar, për dallim nga sektori i industrisë dhe shërbimeve që patën një rënie të lehtë (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu shënuan rënie të normës mesatare të interesit në 7.5 përqind (8.1 përqind në mars 2016). Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare vazhduan të ndjekin trend rënës.

Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat u rrit lehtësisht kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Rritja prej 0.1 pikë përqindje e normës së interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve bëri që norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat të ngritët me po të njëjtin nivel (figura 26).


Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2017)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve arriti në 1.2 përqind, një rritje prej 0.1 pikë përqindje. Më saktësisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara të ndërmarrjeve prej 0.2 përkatësisht 0.1 pikë përqindje (figura 27).

Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2017)

Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbeti e njëjtë me atë të periudhës së njëjtë në vitin paraprak në 0.9 përqind.

Norma mesatare e interesit në depozitat e transferueshme dhe të kursimit shënoi rënie të lehtë, përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara shënoi rritje të lehtë (figura 28).

Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)


Performanca e sektorit bankar⁶

Profiti i sektorit bankar shënoi rritje të theksuar krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rritjes së të hyrave dhe rënies së shpenzimeve të sektorit.

Vlera e profitit të realizuar deri në mars 2017 ishte 21.4 milionë euro, që përbën një rritje vjetore prej 27.6 përqind (figura 29).

⁶ Bazuar në të dhënat e paaudituar.


Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Për dallim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, të hyrat e sektorit bankar u karakterizuan me rritje (figura 30). Në mars 2017, vlera e të hyrave arriti në 58.2 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 1.1 përqind. Rritja e të hyrave kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga jo-interesi, më saktësisht të hyrave nga tarifat dhe komisionet dhe të ardhurat tjera operative. Ndërsa, të hyrat nga interesi patën rënie të lehtë, veçanërisht të hyrat nga interesi për kredi, si pasojë e zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi.

Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2017)


Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 36.8 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 9.8 përqind (figura 30). Në rënieën e gjithsej shpenzimeve, kontributin kryesor e kishte rënieën e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, më saktësisht rënieën e shpenzimeve tjera nga jo-interesi. Rënie të shpenzimeve kishte edhe në kategorinë e shpenzimeve nga jo-interesi, ku rënieën më të madhe e kishin provizionet për humbje nga kreditë dhe shpenzimet për tarifa dhe komisione. Po ashtu, rënie shënuan edhe shpenzimet e interesit, veçanërisht shpenzimet për interesat në depozitat e klientëve.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit u përmirësua, duke rënë në 63.2 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së të hyrave dhe rënies së shpenzimeve në këtë periudhë (figura 30).

Në periudhën raportuese, treguesit e profitabilitetit shënuan rënie të lehtë pavarësisht rritjes së profitit të realizuar, që mund t'i atribuohet anualizimit të vlerës së fitimit për performancën e sektorit bankar deri në mars 2017.

Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u zvogëluan lehtësisht në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 31).

Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




*Për 2017 treguesit e profitabilitetit janë logaritur duke u bazuar në performancën deri në mars 2017
Burimi: BQK (2017)

Treguesit e shëndetit financiar

Deri në mars 2017, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese shënoi rënie në 4.5 përqind, një shkallë e ulët krahasuar me vendet në Ballkanin Perëndimor (figura 32).

Figura 32. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2017)


Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione shënoi rritje në 134.1 përqind.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me treguesin e mjaftueshmërisë

së kapitalit në 18.3 përqind në mars 2017.

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në krahasim me vitin paraprak.

Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Burimi: BQK (2017)

Në këtë zhvillim ndikoi në një rritje të detyrimeve afatshkurtra, që reflekton pjesëmarrjen më të lartë të depozitave të transferueshme në kuadër të gjithsej depozitave, si dhe rënies së mjeteve likuide, si pasojë e zhvendosjes së aseteve likuide në asete afatgjata. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit (figura 33).


Në mars 2017, sektori bankar shënoi rritje të theksuar të profitit si rezultat i rritjes së të hyrave dhe zvogëlimit të shpenzimeve. Niveli i kredive joperformuese vazhdoi të përcjellë trend rënës, duke zbritur në normën më të ulët të kredive joperformuese kundrejt vendeve në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit.

Sektori pensional

Në TM1 2017, sektori pensional shënoi rritje të përsheptuar vjetore të aseteve prej 18.1 përqind. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 1.50 miliard euro, që paraqet sektorin e dytë më të madh në sistemin financiar me 27.3 përqind të aseteve (figura 34). Rritja e aseteve të sektorit pensional kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së kontributeve të reja dhe kthimit në investime gjatë kësaj periudhe.

Vlera e arkëtimeve të reja arriti në 37.7 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 36.2 milionë euro në mars 2016. Vlera e arkëtimeve të reja të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-së) arriti në 37.6 milionë euro, ndërsa ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-së) arriti në 129.8 mijë euro.

Figura 34. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Sektori pensional rriti dukshëm kthimin në investime në 47.0 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 6.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. FKPK realizoi kthim pozitiv në investime prej 46.7 milionë euro, ndërsa FSKP 268.0 mijë euro. Treguesit shumë të mire

makroekonomik në SHBA ndikuan që indekset kryesore të shënojnë rritje, duke ndikuar dukshëm në kthimin pozitiv në investime të FKPK-së. Për më tepër, edhe plani i Presidentit për uljen e taksave ndikoi dukshëm në optimizmin e investitorëve. Aryeje tjetër e rritjes së kthimit pozitiv në investime mund të jetë edhe rritja ekonomike në Europë dhe mbajtja në fuqi e masave stimuluese nga BQE.

FKPK, që përbën 99.5 përqind të aseteve të sektorit pensional, ndërroi strategjinë investive në krahasim me vitin e kaluar, duke u orientuar në investimet jashtë vendit. Investimet e fondit jashtë vendit arritën vlerën prej 1.4 miliardë euro (1.1 miliardë euro në mars 2016), për dallim nga investimet jashtë Kosovës që shënuan rënie në 111.2 milionë euro (184.3 milionë euro në mars 2016) (figura 35).

Figura 35. Investimet e FKPK-së (milionë euro)



Burimi: FKPK (2017)

Sektori pensional gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 shënoi rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve. Kthimi pozitiv në investime si dhe rritja e kontributeve të reja ishin dy faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rritje. FKPK zhvendosi investimet nga ato në Obligacione Qeveritare të Republikës së Kosovës kundrejt investimeve në fondet e përbashkëta investuese jashtë vendit.

Sektori i sigurimeve



Sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në mars 2017 shënoi rritje vjetore më të ngadalësuar prej 5.3 përqind (figura 36). Një ndër kontribuesit kryesor në rritjen e aseteve të sektorit të sigurimeve ishte rritja e parave të gatshme të mbajtura në bankat komerciale, që ka pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit.

Sigurimet jo-jetë, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit me 89.8 përqind të gjithsej aseteve, shënuan rritje vjetore prej 4.9 përqind. Ndërsa, sigurimet 'jetë', që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 8.8 përqind.

Deri në mars 2017, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arritën vlerën prej 19.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.7 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë, të cilat përfaqësojnë 96.7 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e realizuar e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 18.7 milionë euro në mars 2017, që tregon për një rritje vjetore prej 2.0 përqind. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë arriti vlerën 641.5 mijë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 7.2 përqind.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje në 11.3 milionë euro në TM1 2017 (8.5 milionë euro në TM1 2016).

Rritja më e vogël e primeve të pranuar gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të lartë të dëmeve të paguara ndikoi në rritjen e raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 37).



Burimi: BQK (2017)

Burimi: BQK (2017)

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të profitit në mars 2017 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Të hyrat neto të sektorit të sigurimeve në mars 2017 arritën vlerën prej 18.4 milionë euro, përderisa shpenzimet shënuan rënie në 8.9 milionë euro. Rënia e shpenzimeve u reflektua në rritjen e profitit të regjistruar nga sektori i sigurimeve në 912.1 mijë euro në TM1 2017, nga profiti prej 498.7 milionë euro i realizuar në periudhën e njëjtë të vitit.⁶ Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë' (fitim prej 808.0 mijë euro), përderisa performanca pozitive financiare e sigurimit 'jetë' ishte 104.1 mijë euro.

Rritja vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 3.0 përqind, krahas rritjes së konsiderueshme prej 26.6 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve, u reflektuan në përkeqësimin e nivelit të likuiditetit të sektorit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 92.7 përqind në mars 2017 (114.0 në mars 2016), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëluar në 84.6 përqind (100.7 në mars 2016).


Sektori i sigurimeve në mars 2017 shënoi rritje të aseteve. Performanca financiare e këtij sektori u përmirësua, duke u karakterizuar me rritje të të hyrave neto dhe të profitit, si dhe rënie të shpenzimeve.

Sektori mikrofinanciar

Asetet

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 156.8 milionë euro, duke shënuar rritje të theksuar vjetore prej 26.2 përqind (figura 38).

Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar (milionë euro)



Burimi: BQK (2017)


Kontribuues kryesor në rritjen e aseteve të sektorit ishte rritja e kredive bruto, që kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm, e që dominojnë strukturën e përgjithshme të aseteve të sektorit mikrofinanciar (75.4 përqind), pasuar nga lizingjet (14.5 përqind).

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 u karakterizua me rritje të theksuar të vlerës së kredive prej 33.6 përqind (figura 39).

⁶ Bazuar në të dhënat e paaudituar.

Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive




Burimi: BQK (2017)

Ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 65.2 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, u karakterizuan me rritje vjetore prej 34.4 përqind. Gjithashtu, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 34.8 përqind të gjithsej kredive të sektorit, shënuan një rritje vjetore prej 32.3 përqind.

Sa i përket kredive të lëshuara, kategoria ndaj ‘sektorëve tjerë’ shënoi rritjen më të lartë vjetore, pasuar nga bujqësia, tregtia, ndërtimtaria dhe industria.

Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)


Vlen të theksohet se në tremujorin e parë të vitit 2017, sektori i tregtisë shënoi rritjen më të shpejtë të

kreditimit prej 34.3 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur ky sektor kishte shënuar rënie vjetore prej 2.1 përqind (figura 40).

Lizingjet

Në tremujorin e parë të vitit 2017, lizingjet shënuan rritje vjetore prej 7.0 përqind, kundrejt rënies së shënuar në vitin paraprak prej 6.4 përqind (figura 41).

Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar (përqindje)



Burimi: BQK (2017)


Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e lizingjeve hipotekare dhe ‘lizingjeve tjera’, që shënuan rritje vjetore prej 6.4 përkatësisht 14.8 përqind.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në tremujorin e parë të vitit 2017 vazhdoi të përcjellë trendin rënës, duke rënë në 22.7 përqind.


Për të dy kategoritë, gjegjësisht, norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rënie prej 0.2 përqind përkatësisht 0.5 përqind (figura 42).

Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë, përkundër rënies së vazhdueshme, vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi (figura 43).


Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Performanca e sektorit mikrofinanciar

Në tremujorin e parë të vitit 2017, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 1.8 milionë euro, krahasuar me profitin në vlerë prej 0.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Rritja më e lartë e të hyrave (kryesisht e atyre nga interesi) krahas rritjes së shpenzimeve ndikoi në profit më të lartë të realizuar në këtë periudhë (figura 44).


Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim (figura 45).

Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë në tremujorin e parë të vitit 2017 u zvogëlua për 1.3 pikë përqindje kundrejt vitit paraprak në 2.9 përqind, nivel ky më i ulët në vitet e fundit (figura 46).

Figura 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2017)

Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizioneve shënoi rritje të theksuar në 208.9 përqind, ndikuar kryesisht nga rënia e vlerës së kredive joperformuese (figura 46).

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përshpejtim të rritjes së asetëve në tremujorin e parë të vitit 2017. Gjithsej kreditë vazhduan të shënojnë rritje, përdërisa norma mesatare e interesit përcjelli trend rënës. Sektori shënoi rritje të theksuar të profitit, përdërisa edhe cilësia e portofolit kreditor u përmirësua dukshëm.

Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, në tremujorin e parë të vitit 2017 numri i ankandëve për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës arriti në 4. Vlera e shpallur në ankande ishte 80.0 milionë euro.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, numri i bonove të thesari mbeti i ngjashëm me periudhën e njëjte të vitit paraprak, përdërisa numri i fletë-obligacioneve shënoi rënie (tabela 2). Sa i përket shumës së emetuar, vlera e pranuar e bonove të thesarit mbeti e

ngjashme krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2016, përdërisa vlera e pranuar e fletë-obligacioneve shënoi rënie të ndjeshme.

Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës


Periudha	Numri i bonove të thesarit	Vlera e pranuar e bonove të thesarit	Numri i fletëobligacioneve	Vlera e pranuar e fletëobligacioneve
Janar-Mars 2014	5	106.40	1	10.00
Janar-Mars 2015	4	80.00	1	20.00
Janar-Mars 2016	3	60.00	3	60.00
Janar-Mars 2017	3	60.00	1	20.00

Burimi: MF (2017)

Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregojë tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër (364 ditë) në letra me vlerë me maturitet afatgjatë (5 vite).

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletë obligacionet me afat maturimi pesë vite (figura 47).

Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje




Burimi: BQK (2017)

Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit tejkaloi shumën e shpallur në ankande nga Ministria e Financave për 2.29 herë (2.65 në mars 2016). Në tremujorin e parë të

vitit 2017, është vënë re një rënie e ofertës dhe njëkohësisht rënie e emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Në vitin 2016, norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka shënuar rënie në 0.31 përqind (1.53 përqind në tremujorin e parë të vitit 2016). Në këtë periudhë, normat e interesit për të gjitha afatet e maturimit ishin më të ulëta krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2016 (figura 48).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2017): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 18 TM1 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2017):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2017):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2017): Metal Prices database.

FAOUN (2017): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2017): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2017): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2016	TM1 2017
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	1,214.0	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.1%	1.6%
Çmimet (fondi i periudhës)	0.1%	1.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	329.3	339.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	326.5	333.4
Bilanci primar (në milionë euro)	2.8	5.9
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,950.7	5,493.9
prej të cilave: Bankat	3,397.8	3,669.8
Kredi	2,070.2	2,294.9
Depozita	2,664.0	2,911.6
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	7.4	7.0
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	0.9	1.0
Hendeku i normës së interesit	6.5	6.1
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-138.7	-166.7
prej të cilave: remitencat e pranuar	144.3	163.4
Llogaria financiare	-3.4	-83.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	55.6	68.4
Investimet portfolio, net	80.8	-22.6
Investimet tjera, net	-67.9	-101.0
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, net	-17.5	1.1
Asetet	4,391.5	4,667.3
Detyrimet	4,409.0	4,666.2
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,931.8	2,045.0
Borxhi i jashtëm privat	1,490.0	1,600.4
Borxhi i jashtëm publik	441.8	444.6

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

